

Realizime 2008 METE

ARRITJET ME TE SPIKATURA

- **Eshte privatizuar operatori i Sistemit te Shqperndarjes, aktualisht eshte ne fazen e fundit te negociimit kontrata e shitblerjes se aksioneve me shqerine CEZ qe rezultoi fituese e tenderit;**
- **Eshte miratuar Modeli Shqiptar i Tregut te Energjise Elektrike, ne mars 2008**
-
- **Eshte privatizuar shoqeria ARMO sha, me nje vlere prej 128 milion Euro, ka perfunduar nenshkrimi kontrates me kompanine fituese Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group,dhe eshte bere dorezimi I saj.**
- **Eshte privatizuar AMC**
- **Arrirem te furnizojme maksimalisht konsumatorin e biznesit dhe ate familjar me energji elektrike.**
- **Jane nenshkruar 50 kontrata koncesioni per ndertimin dhe operimin e hidrocentraleve me investitore private vendas edhe te huaj. Kompanite lider ne sektorin hidroenergetik ne Europe, sikurse VERBUND, EVN, STATKRAFT, ATEL etj. jane tashme prezente ne Shqiperi dhe kane marre persiper investime serioze ne kete sektor;**
- **Eshte nenshkruar kontrata dhe pritet te fillojne punimet per ndertimin e Hec-it te Ashtes.**
- **Eshte nenshkruar kontrata dhe pritet te ratifikohet ne parlament me kompanite EVN dhe Statkraft per projektin e kaskades se devollit me nje vlere rreth 1 bln Euro.**
- **Eshte nenshkruar kontrata per ngritjen e rigazifikatorit ne Seman te Fierit, investim prej 950 milion euro nga grupi Falcione;**
- **Jane bere hapa konkrete ne Energjine e Rinovueshme: Kompania Moncada eshte licencuar per ndertimin e nje Parku Energjetik me Ere me nje fuqi te instaluar prej 500 mw, ndersa nje Park tjetër i kombinuar energji ere dhe biomase eshte dhene ne Shengjin.**
- **Jane licensuar 176 subjekte te reja minerare; investimet private ne kete sektor jane rritur nga 32,6 mln USD per vitin 2007 ne 54.2 mln USD per vitin 2008; numri i punonjesve ne kete sector eshte rritur nga 1800 te punesuar ne vitin 2005 ne 7000 te punesuar per vitin 2008;**
- **Ka filluar implementimi i Programit per mbeshtetjen e SME-ve**
- **Kane perfunduar procedurat per krijimin e 7 Zonave Ekonomike me statusin “Park Industrial”**
- **Eshte miratuar parku energjetik ne Porto Romano**
- **Eshte hartuar ligji per ngritjen e Qendres Kombetare te Licensimit dhe ka hyre ne efience te plote QKR.**
- **Eshte miratuar ligji i ri per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”**
- **Jane miratuar ligjet e reja per Akreditimin, Standardet dhe Metrologjine**
- **Eshte miratuar ligji i ri “per mbrojtjen e konsumatorit”;**
- **Eshte miratua ligji i ri per Pronesine Intelektuale;**
- **Eshte Hartuar strategjia “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri”**
-

Ne total numerohen rreth 217 objektiva te programuara per METE-n, prej te cilave 190 jane realizuar, 23 jane ne proces dhe 4 jane te porealizuara, e shprehur ne perqindje mund te themi se jane realizuar 88% e objektivave te parashikuara.

❖ PRIVATIZIMI

(i)Sektori strategjik

1. Ristrukturimi i KESH Sh.a. privatizimi i OSSH sha

Pas pergatitjes dhe miratimit te akteve perkatese nenligjore per realizimin e procesit te privatizimit, ne daten 2 Qershor 2008 u realizua faza parakualifikuese e tenderit per perzgjedhjen e investitoreve strategjike per privatizimin e OSSH sh.a, dhe kompanite pjesmarrese (EVN AG; ENERGIE STEIERMARK AG; CEZ, a.s; ENEL S.p.a), u cilesuan si "Ofertues te parakualifikuar".

Ne muajin Shtator 2008 u realizua tenderi per privatizimin e paketes 76% te aksioneve shteterore te shoqerise OSSH-se. Komisioni i Vleresimit te Ofertave kualifikoi si fitues kompanine CEZ, a.s, me oferte financiare prej 102 milion Euro.

Aktualisht, Keshilli i Ministrave ka miratuar Raportin e Vleresimit te Ofertave dhe ka shpallur fituese kompanine CEZ, a.s, me te cilen jane duke u zhvilluar negociimet per kontraten e blerjes se aksioneve.

2. Privatizimi i shoqerise ARMO sha.

Ne daten 21 Maj 2008 u realizua tenderi nderkombetar per privatizimin e kesaj shoqerie, proces i cili u asistua nga kompania konsulente nderkombetare Patton Boggs.

Ne mbeshtetje te kritereve te percaktuara ne VKM Nr. 82 , date 03.02.2008 u realizua vleresim tekniko-financiar i ofertave, ne perfundim te te cilit u kualifikuan 3 kompani:

Ne baze te Raportit Perfundimtar te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, Keshilli i Ministrave me VKM nr. 867, date 18.06.2008, shpalli fitues oferten e paraqitur nga kandidati Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group, me vlere 128 Mln Euro. Pas perfundimit te procesit te negociimit, ne daten 27 Nentor 2008 u nenshkrua kontrata per blerjen e aksioneve.

3. Privatizimi i paketes shteterore ne shoqerine AMC:

Ne kuader te realizimit te procesit te perzgjedhjes se konsulentit nderkombetar, qe do te asistojte procesin e transferimit te paketes se aksioneve shteterore ne shoqerine AMC, perfundoi vleresimi i kompanive te parakualifikuara dhe u klasifikua si fituese kompania UniCredit, e cila po asiston ne realizimin e procedurave per procesin e vleresimit dhe shitjes se aksioneve te mbetura shteterore ne shoqerine AMC.

Ne daten 20 Nentor 2008 u paraqiten Shprehjet e Interesit nga kater kompani, te cilat u parakualifikuan. Ne daten 10 Shkurt 2009 jane paraqitur ofertat per blerjen e paketes se aksioneve shteterore ne shoqerine AMC.

(ii)Sektori jostrategjik

Krijimi i Fondit te Kompensimit Fizik

Jane miratuar nga Keshilli i Ministrave, per efekt te krijimit te fondit te kompensimit fizik, 4 VKM, ne baze te te cilave jane hartuar listat dhe pasqyrat e nevojshme ne rakordim me institucionet e varesise administrative duke kaluar ne fond kompensimi fizik:

- 17 335 ha toke bujqesore;
- 71 699.3 ha, pyje dhe kullota;

Procesi i privatizimit

Eshte punuar per perгатitjen e praktikave per vazhdimin e procedurave te privatizimit per shoqerite aksionere, shoqerite me pergjegjesi te kufizuar dhe aseteteve te ndryshme prone shtetore, duke realizuar nje shitje transparente dhe duke siguruar ushtrimin e te drejtes se parablerjes se pronareve te truallit ne menyre maksimale, si dhe duke siguruar te ardhura per shtetin.

a. Shoqerite aksionere

Jane mbledhur materialet e nevojshme dhe jane kryer analizat e duhura, ne lidhje me veprimtarine e shoqerive aksionere me kapital 100% shtetor dhe ato me pronesi mikse qe mund te perfshihen ne procesin e privatizimit duke ndjekur te gjitha procedurat e duhura ligjore per kete qellim.

b. Shoqerite me pergjegjesi te kufizuar

-Eshte ndjekur dhe mbikqyrur procesi i vleresimit per privatizimin te kuotave shtetore per 6 Sh.p.k, per efekt te shitjes se pjeses shtetore, te cilat jane ne faza te ndryshme, si jane dorezuar raportet e vleresimit per 2 sh.p.k, dhe jane ne proces te konfirmimit te gentplaneve si dhe ne pritje te konfirmimeve nga ZRPP 3 Sh.p.k dhe 1 Sh.p.k eshte ne proces vleresimi nga ekspertet.

-Eshte perгатitur dokumentacionit perkates, sipas urdherit nr. 526, date 07.07.2008 te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes per privatizimin e kuotes shtetore prej 10.66% ne kapitalin e shoqerise "Euro Druri" Sh.p.k Tirane.

-Eshte derguar ne DASHPP ne Ministrine e Financave dosja e vleresimit te kuotes shtetore te Sh.p.k "Euro Druri". Ne gusht 2008 u realizua me ankand shitja e kesaj kuote me vlere 31 160 000 leke.

c. Asete shtetore

-jane miratuar per tu perfshire ne proceduren e privatizimit rreth 170 objekte, ne zbatim te 92 urdherave te privatizimit.

-jane ngritur 134 komisione vleresimi per te bere te mundur fillimin e procedures se vleresimit sipas legjislacionit ne fuqi.

-jane kontrolluar rreth 223 dokumentacione vleresimi objektesh nga te cilat kane rezultuar te rregullta, dhe jane derguar per te vazhduar proceduren e shitjes ne Ministrine e Financave (Drejtorine e Administrimit tdhe Shitjes se Prones Publike) 129 dosje vleresimi me rreth 320 objekte.

Te ardhura nga privatizimi ne sektorin e privatizimit te aseteteve

❖ Gjate vitit 2007 ishte realizuar nga privatizimi i aseteteve nje e ardhur prej 206.426.000 leke, si rezultat i punes se bere gjate **vitet 2008 eshte realizuar nje e ardhur prej 906 060 000 leke.**

❖ POLITIKAT ENERGETIKE DHE INDUSTRIALE

Shqiperia gjate ketyre viteve eshte perballur me veshtiresi per furnizimin me energji te konsumatoreve te vet. Mungesa e burimeve primare te energjise, mungesa e rjetit dhe burimeve te

gazit, kapacitete te limituara ne prodhimin e energjise elektrike dhe ne linjat e interkonjeksionit dhe varesi e plote e prodhimit te energjise elektrike nga HEC-et, perbejne disa nga keto veshtiresi.

Viti 2007 ishte viti me i thate ne te gjithë historine e kaskades se Drinit dhe prandaj dhe importi ishte me i madhi i arritur deri me sot.

Dhe viti 2008 ishte nje vit jo i mire (mesataja shumevjecare eshte 4,200 GWh), por ne mesin e muajit Nentor 2008 situata hidrike filloi te permiresohet dhe keshtu vazhdon te jete edhe sot. Per te mos derdhur uje ne po eksportojme energji elektrike.

Prodhimi neto nga burimet e brendshme ne vitin 2008 ka nje rritje prej 34% ne krahasim me vitin 2007, energjia ne rrjet eshte rritur me rreth 10 %,si dhe kufizimet jane ulur me me teper se 50% ne krahasim me periudhen e vitit te kaluar duke ulur kufizimet nga mesatarisht x ore ne dite ne y.,duke iu afruar se tepermi objektivit ambicioz te ketij mandati qeverises per furnizim pa nderprerje 24 me energji elektrike.

Reforma ne permiresimin dhe fuqizimin e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar

Keshtu, gjate ketij viti u ndoqen punimet per ndertimin e TEC te Vlores, ndertimit te HEC-it te Kalivacit, procedurat per dhenien me koncesion te HEC-it te Ashtes, te hidrocentraleve te Kaskades se Devollit, te kaskades se Skavices, si dhe te nje sere hidrocentralesh te fuqive te mesme dhe te vogel.

Per te fuqizuar rrjetin e transmetimit te brendshem dhe sidomos ate te interkonjeksionit me rrjetet rajonale, gjate vitit 2008 u perqendrua puna ne fillimin e punimeve ne disa objekte kryesore, si:

Ne ndertimin e linjes 400 kV te interkonjeksionit Shqiperi – Mali i Zi, e cila eshte ne implementim dhe qe do te rrise ne menyre te dukshme kapacitetet importuese te vendit tone. Pritet qe segmenti Tirane- Podgorice i kesaj linje te perfundoje brenda ketij viti.

Paralelisht me kete linje po punohet per ndertimin e segmentit tjeter Tirane-Elbasan, per ndertimin e nenstacionit te ri 400/220 kV ne Tirane, te Qendres se re Kombetare Dispecer, etj.

Per lidhjen e sistemit tone me Italine jane dhene tre Leje per ndertimin e Linjave Tregtare per tre kompani Italiane.

Reforma organizative dhe strukturore ne sektorin elektrik

Si rezultat i shume operacioneve te kryera aktualisht sh.a KESH-i, nga nje shoqeri vertikalisht e integruar, eshte ndare ne tre shoqeri anonime konkretisht: sh.a KESH, sh.a OST, dhe sh.a OSSH, Paralelisht me keto shoqeri publike, ne tregun e energjise elektrike tashme operojne me dhjetra operatore private sidomos ne sektorin e prodhimit dhe te tregtimit.

Reforma ligjore dhe integrimi ne tregun rajonal

-Ketu mund te permendim amendimin ne muajin Maj 2008, te ligjit baze “Per sektorin e energjise elektrike”, i cili eshte ne perputhje te plote me direktiven 2003/54 te B.E.-se.

-Njekohesisht eshte hartuar kuadri dytesor dhe ai rregullator ne perputhje te plote me direktiven perkatese te B.E.-se dhe konkretisht ne muajin Mars 2008 **u miratua Modeli Shqiptar i Tregut te Energjise Elektrike**. Ne muajt ne vijim u pershtaten me kushtet e reja te tregut Regullat e Tregut, Kodi i Transmetimit, Kodi i Shperndarjes, Kodi i Matjes si dhe u hartuan nga e para kontratat tip per marredheniet midis operatoreve te tregut.

Reforma tarifore Keshtu, krahas rritjes se çmimeve dhe tarifave eshte bere kujdes i jashtezakonshem per mbrojtjen e konsumatorit familjar dhe biznesit.

Per vitin 2009, qe do te jete viti i pare i veprimtarise se operatorit privat ne sektorin e shperndarjes, nuk do te kete rritje çmimi te energjise elektrike me qellim qe konsumatori shqiptar te mos penalizohet nga ky privatizim.

Projektet ne fushen e energjise

Marreveshja e Bashkepunimit me Italine, miratuar me VKM Nr.820 date 29.11.2007, parashikon dhenien e nje mbeshtetje financiare prej 5 milion euro (shume e cila do te disbursohet brenda 3 vjeteve nga data e nenshkrimit te marreveshjes), me qellim bashkefinancimin e projekteve Clean Development Mechanism, qe do te mbulojne sektoret e (i) eficences se energjise dhe (ii) energjine e rinovueshme.

Gjate vitit 2008 jane realizuar keto faza te zbatimit te marreveshjes:

1. Jane ngritur strukturat e pales shqiptare per zbatimin e projekteve
2. eshte pergatitur dhe miratuar nga Komitetit I Perbashket, **rregullorja e funksionimit dhe bashkepunimit te Komitetit te Perbashket, Sekretariatit Teknik dhe Grupit te Zbatimit te Projekteve** si dhe menyren e raportimit te Komitetit te Perbashket, duke percaktuar rolin dhe detyrat per secilen strukture. Kjo rregullore ka marre formen perfundimtare, duke marre edhe propozimet e pales italiane, dhe eshte miratuar nga Komiteti i Perbashket.
3. eshte hartuar dhe publikuar **call for proposal for expression of interest, per marrjen e shprehjeve te interes nga investitore te intereuser per keto**

Me perfundimin e afatit per dorezimin e project-ideve (22 Mars 2009 do te procedohet nga Grupi i Zbatimit te Projekteve per procedurat e perzgjedhjes se kompanise fituese.

Projekti I Kfw per energjite e rinovueshme dhe eficencen e energjise ka pasur nje progress te ngadalshem kjo dhe per faktin e mangesive te verejtura keto qe ne fazen e konceptimit te ketij projekti. Gjithsesi me perpjekje eshte arritur te filloje implementimi I ketij projekti ne ted y komponentet e saj. Ne muajin mars do te zhvillohet dhe nje conference nderkombetare e cila do ti jape nje shtyese te re ketij projekti..

Projekti ne bashkepunim me UNDP per ‘Transformimin e tregut te ngrohjes solare dhe te ujit’ ka pasur ecuri te ngadalte dhe duhet te shpejtojme hapan e nevojshem per fillimin e implementimit te ketij projekti.

Sektori Hidrokarbur

Formulimi I politikave

-Eshte realizuar studimi “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj” i miratuar nga Keshilli i Ministarve me VKM nr. 70 3, date 23.04.2008.”. KRRT e qarkut te Durrësit e ka miratuar kete masterplan ne mbledhjen e saj date 10.11.2008.

-Eshte ndjekur ecuria e kontratave të koncesionit për shoqërinë “Romano Port”sh.a. për Pontilin e Porto Romanos dhe për shoqërinë “La Petrolifera Italo Albaneze” për Terminalin bregdetar të Gjirit të Vlorës. Aktualisht Pontili Detar i Porto Romanos ka përfunduar ndërtimin, ndërkohë që KRRTSH në mbledhjen e datës 13 janar 2008 miratoi edhe ndërtimin e dallgëthyesit si pjesë e kësaj infrastrukture.

-Eshte punuar ne drejtim te promovimit te projektit te gjurmes se gazsjellsit TransAdriatik (TAP dhe përfshirjes se tij ne projekt idene e gazsjellsit te Ballkanit Perendimor (pjesë e Energy Community Gas Ring) ku zhvillim pozitiv duhet konsideruar prfshirja në të e kompanisë norvegjeze StatoilHydro, që tashmë është 50% me 50% me EGL. Gjithashtu janë realizuar shumë takime dhe diskutime për ecurinë e projektit TAP, si përsa i përket linjës së gazsjellësit, ashtu edhe stokimit nëntokësor të gazit në strukturën e diapirit kripor të Dumresë.

-Ndër projektet prioritare për sektorin e gazit ka qënë edhe zhvillimi i projektit të gazsjellësit Ionian Dadriatic Pipeline (projekti IAP), per lidhjen e Shqiperise-Malit te Zi dhe Kroacise. Për këtë projekt krahas vazhdimit të bashkëpunimit me vendet pjesamrrëse, të cilat kanë nënshkruar edhe Deklaratën Ministeriale në Zagreb, në shtator 2007, në Dhjetor 2008 kësaj Deklarate ju bashkua edhe Bosnja e Hercegovina. Projekti IAP, duke qënë pjesë e Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, përbën njëkohësiht një projekt që ka suportin edhe të Komunitetit të Energjisë ashtu edhe të strukturave përkatëse të Komisionit Evropian.

-Eshte nenshkruar kontrata me Shoqerine “Trans European Energy B.V” sh.a., 02.12.2008, për ndërtimin dhe përdorimin e terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) në parkun energjetik në bregdetin e Qarkut të Fierit , të gazsjellësit nëndetar Shqipëri – Itali, si dhe të rrjetit të gazit në territorin Shqiptar. **Aktualisht kontrata eshte ne procedure miratimi per ne KM.**

Nxitja e investimeve te huaja ne fushen e kërkimit dhe te prodhimit te naftes dhe gazit ne teritorin Shqiptar.

Gjatë vitit 2008, është ndjekur problematika që ka të bëjë me zbatimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure, duke patur ne konsiderate qe gjate ketij viti ka hyre ne fuqi edhe ligji 9975, date 28.07.2008 “Per taksat kombetare”, sipas te cilit shoqerite qe prodhojne naftë brut ne vendin tone do te paguajne edhe taksen per renten minerare. Per kete qellim eshte bere edhe amendimi i ligjit nr. 7811, date 12.4.1994 “Mbi aprovimin e Dekretit nr. 782 te Presidentit “Mbi sistemin Fiskal ne Sektorin Hidrokarbur(Kerkim – Prodhim).

Eshte bere ndjekja dhe zbatimi i projekteve me fonde CARDS 2004, 2005, 2006 per rehabilitimin e ambjentit ne Rubik, Fier dhe Vlore. Projektet e Rubikut dhe Fierit jane ne perfundim e siper, kurse projekti i Vlores eshte ne proces tenderimi nga Komisioni Evropian.

PERMIRESIMI I KLIMES SE BIZNESIT DHE INVESTIMEVE PER NJE ZHVILLIM TE QENDRUESHEM

-Ne fund te vitit 2008 eksportet kane arritur ne afersisht **914 Mln/€** me nje rritje mesatare vjetore prej **16.5 % ne krahasim me 2007** . Ndersa vetem eksportet made in Albania te ekonomise shqiptare rezultojne me rritje, duke u vleresuar ne fund te vitit 2008 ne 380 Mln/€ ose 40 % e totalit te eksporteve nga 29.6 % qe ka zene ne vitin 2005.ndersa importet jane rritur 16.9%.Raporti Eksp/Import vazhdon te jete negativ ne 1:4.

-Per here te pare eshte hartuar **programi strategjik per zhvillimin e SME-ve 2007 – 2009**.

-Numri i biznesve te reja te regjistruara gjate vitit 2008 arriti ne 17.700 subjekte. Ky numer eshte me i larte se i gjithë viti 2007 me nje rritje 29%.(13.764)

-Kreditimi i ekonomise ka shenuar nje rritje te dukshme gjate vitit 2008 me gjithë ndikimin e krizes nderkombetare financiare.. Portofoli i kredisë së sistemit bankar është rritur me ritme të shpejta gjatë vitit 2008, duke zene 36% te GDP.

Programi Italian per mbeshtetjen e SME-ve

Jane ngritur strukturat e menaxhimit te programit: Komiteti Drejtues, emeruar drejtori i PMU, perzgjedhur stafi i PMU-se qe tashme eshte ne funksionim te plote.

Eshte hartuar marreveshja e kredise midis METE dhe bankave tregtare, per dhenie kredie per SME-te. Jane nenshkruar 5 marreveshje me bankat implementuese si dhe me banken agjente dhe pritete filloje disbursimi i kredise. .

Monitorimi i zbatimit te planit te veprimit per ekonomine informale

Nga monitorimi i deritanishem i zbatimit te planit te rishikuar te veprimeve per reduktimin e ekonomise informale, sipas VKM Nr.430, date 28.06.2006 "Per reduktimin e ekonomise informale per peridhen 2006-2009" rezulton se: nga 33 masa te programuara gjithsej ne planin e veprimit, jane realizuar 29 masa ndersa 4 te tjera jane ne proces per vitin 2009.

Monitorimi i zbatimit te Planit te veprimit per anetaresimin ne NATO – MAP per fushat e METE Eshte pergatitur informacioni lidhur me monitorimin e realizimit te masave te planit te veprimeve (MAP) te METE per anetaresimin ne NATO dhe eshte derguar prane Koordinatorit Kombetar per Anetaresim ne NATO dhe MPJ. Nder keto masa jane ato lidhur me ristrukturimin dhe privatizimin e KESH, Sh.a, ARMO Sh.a, Servcom & Albetrol Sh.a, paketes shtetere te AMC, vazhdimi i kontrates koncesionare Ujesjelles-Kanalizime Elbasan si dhe realizimi i masave per reduktimin e ekonomise informale.

Programin e Konkureshmerise dhe novacioneve per SME-te. CIP-EIP.

Sipas vendimit te Parlamentit European Nr.1639/2006/EC per fillimin e programit per **Konkureshmerine dhe novacioneve(CIP)** per periudhen 2007-2013 eshte e lejuar qe te aplikojte dhe te marre pjese edhe Shqiperia. Memorandumi i mirekuptimit per pjesemarrjen e Shqiperise ne nenprogramin e Siper marrjes dhe Novacionit EIP, te programit per Konkureshmerine dhe Novacionin CIP, u firmos me 27 qershor 2008 ne Bruksel dhe u miratua me pas me **Ligjin Nr.9984, date 11.09.2008**, hyre ne fuqi me date **6 tetor 2008**.

Monitorimi i Fondit te Garantimit te Kredive ne Eksport

Ne zbatim te VKM-se, Nr.489, date 25.07.2007 "Per Fondin e Garantimit te Kredive per Eksport (FGKE), Njesia e zbatimit te FGKE-se prane Albinvest gjate vitit 2008 ka realizuar nje volum pune te konsiderueshem ne drejtim te promovimit te ketij fondi. Kane shfaqur interes mbi 40-kompani private, por 17 prej tyre kane aplikuar per te perfituar nga ky fond. Nderkohe, nga komisioni perkates i vleresimit jane miratuar vetem dy kompani qe kapin vleren e 9-milion lekeve.

Ecuria e perdorimit te Fondit te Konkureshmerise me ndarje kostosh

Mbi 100 kompani te interesuara per te qene perfitues nga Projekti Grant kane kryer regjistrime prane Albinvest, nga te cilat rreth 80 aplikime.

Nga te gjitha keta aplikime, 63-projekte jane shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni i Aprovimit te Grantit.

Vlera totale e angazhuar ne menyre progresive korrik '07– dhjetor '08 ka arritur ne vleren 48 milione leke. Per kete periudhe, 25 milion leke jane angazhuar ne vitin '07, dhe 22.6 mln/lek ne vitin'08 .

Nga 33 kompani aplikuese deri ne dhjetor '08, Albinvest ka rimbursuar nga "Fondi i Konkureshmerise" 23 kompani, te cilat kane perfunduar fizikisht projektet e tyre duke kapur nje vlere prej 15 milion lekesh.

Kerkesat e biznesit per kete Fond Grant jane fokusuar kryesisht ne: ngritjen e “Sistemeve te Manaxhimit te Cilesise” sipas standarteve ISO; Çertifikimin e produktit, misione te biznesit nga eksportuesit shqiptar, permiresim te teknologjive, kerkimeve dhe studimeve te tregut etj.

Parqet industriale

Ne zbatim te programit qeverises u miratua krijimi i 6 (gjashte) parqeve industriale me nje mbulim territorial pothuajse ne te gjithe Shqiperine perkatesisht ne Spitalle/Durres, Shengjin/Lezhe, Koplik/Shkoder, Vlore, Elbasan dhe Shkoder. Implementi i projekteve te paraqitura nga investitoret dhe zhvillueseve potencial te ketyre parqeve, synon thithjen e investimin per nje vlere rreth **55 milion Euro**, si dhe krijimin e mbi **30.000 vendeve** te reja pune.

❖ PROGRAMIMI STRATEGJIK

Eshte bere rishikimi i SKZHI per strategjite qe i takojne METE, si Energjia, Biznesi dhe investimet, Zhvillimi rajonal etj, ne bashkepunim me sektoret pergjegjes si dhe eshte **pergatitur Raport Progresi i SKZHI per vitet 2006 - 2007.**

Eshte pergatitur Plani i Integruar i METE per vitin 2008 i cili eshte miratuar nga Departamenti i Bashkerendimit te Strategjive dhe Koordinimit Donatoreve prane K.Ministrave. Pritet te filloje faza e monitorimit te ketij plani.

Jane pergatitur: Dokumenti i Politikave Prioritare per 2009: Dokumenti i finacimeve te huaja 2008-10, Programi Ekonomik dhe Financiar 2008-2011.

Zhvillimi Rajonal

Eshte pergatitur drafti i projekt-Ligjit “Per Zhvillimin Rajonal” dhe eshte diskutuar me aktoret e interesit ne nivel Vendor, Grupin Keshillimor Jo Qeveritar, nga te cilet u moren komente dhe sugjerime. Shperndarja per komente e draftit final te project-Ligjit, si edhe procesi i paraqitjes se tij per miratim ne Keshillin e Ministrave dhe me pas ne Kuvendin e Shqiperise **eshte pezulluar perkohesisht** per shkak te nderhyrjes se komenteve te Misionit te TAIEX (DG Enlargement), qe vizitoi Shqiperine me 19-22 Maj 2008, i cili ka kerkuar ridiskutimin dhe rishikimin e infrastruktures institucionale per Zhvillimin Rajonal te percaktuar ne SNZHR.

Eshte ne proces diskutimi transformimi i MADA-s ne nje Agjenci Kombetare te Zhvillimit Rajonal per zbatimin e SNZHR, ne kuader te rishikimit te infrastruktures institucionale per Zhvillimin Rajonal ne Shqiperi.

Mareveshjet e bashkepunimit ekonomik dhe tregtar:

Eshte realizuar miratimi dhe nenshkrimi i Marreveshjes se Bashkepunimit ndermjet METE dhe Ministrise se Industrise dhe Tregtise te Republikes Çeke si dhe eshte negociuar Memorandumi i Bashkepunimit me Sllovakine dhe Rusine. Gjithashtu eshte miratuar Marreveshjes se Nxitjes dhe Mbrojtjes se Investimeve te Huaja me Malten, eshte nenshkruar Marreveshjes se Nxitjes dhe Mbrojtjes se Investimeve te Huaja me Bosnje Hercegovinen dhe Libine, si dhe Eshte negociuar Marreveshja e Nxitjes dhe mbrojtjes se investimeve me Qipron.

❖ HARMONIZIMI I INTERESAVE PUBLIKE ME ATO PRIVATE

Reforma Rregullatore

Reforma Rregullatore, e cila tashme ka hyre ne nje faze te re, ka arritur te realizoje nje sere premtimesh te marra nga Qeveria Shqiptare, duke eliminuar apo reduktuar nje pjese te mire te pengesave qe hasen nga biznesi gjate ushtrimit te veprimtarise se tij. Gjithesesi ajo mbetet nje reforme komplekse dhe qe kerkon nje angazhim te madh te te gjithe Institucioneve te perfshira ne te.

Ne fillim te 2008 Task Forca miratoi planin e ri te veprimit te Reformes Rregullatore i cili parashikonte nje sere masash per t'u zbatuar ne kete kuader, masa keto qe lidhen jo vetem me Mete-N, por edhe me angazhimin e ministrive te linjes. Gjate vitit 2008 u zhvilluan disa mbledhje te Task Forces, edhe jashte planit te miratuar, me focus procesin e rendesishem te licensimit.

Projekti BERIS

Ne pergjithesi projekti BERIS gjate vitit 2008 ka patur permiresime te dukshme ne implementim, krahasuar me nje vit me pare. Bazuar ne planin e prokurimit per vitin 2008 te miratuar, eshte realizuar prokurimi i te gjitha paketave te parashikuara. Duhet thene se ne fakt ka patur disa vonesa ne procesin e prokurimit, kjo per shkak te riperseritjes se procesit per perzgjedhjen e konsulenteve apo kompanive (ne varesi te paketes) per arsye te mosmarrjes se shprehjeve te interesit ne perputhje me kriteret e percaktuara ne termat e references. Pavaresisht kesaj, mund te thuhet se ky proces eshte realizuar sic duhet. Eshte bere monitorimi dhe vleresimi i vazhdueshem i ecurise se projektit duke pergatitur ne menyre periodike informacione te detjauara per Z, Minister, si dhe jane pergatitur po ne kete kuader raportet e vleresimit vjetor dhe gjashte mujor te cilet jane bere publike dhe ne faqen e web-it te ministrise.

Lehtesimi i hyrjes ne biznes.

Objektivi kryesor ne kete drejtim eshte pikerisht sistemi i vleresimit te impaktit te reformes ose sic quhet ndryshe RIA (pakete e projektit BERIS). Permiresimi i cilesise rregullatore dhe zhvillimi i sistemit te vleresimit te ndikimit te reformes u percoll gjate vitit 2008 me perpjekje te gjithanshme per te mundesuar zhvillimin e tenderit per perzgjedhjen e konsulenteve qe do te mbeshtesin me ekspertize sistemin e Vleresimit te Impaktit te Reformes. Gjate vitit 2008 u perzgjodh firma konsulente e cila plotesonte kushtet e kerkuara, nepermjet termave te references ne fushat e licensimit, inspektimit, si dhe krijimit te regjistrit per ligjet e biznesit.

Permiresimi i kuadrit ligjor ekzistues.

Objektivi kryesor ne kuader te koordinimit dhe zbatimit te aktiviteteve te Reformes Rregullatore, pergjate vitit 2008, ka qene hartimi i ligjit per ngritjen e **Qendres Kombetare te Licensimit**. Realizimi i ketij objektivi u parapri nga nje pune pergatitore qe perfshin inventarizimin e lejeve, licencave, certifikatave dhe autorizimeve te leshuara nga Institucionet Qendrore si dhe hartimi i matricave sipas ministrive, ne perputhje me rekomandimet e Grupit te Licensimit dhe vendimet e Task Forces. Per arrijten e ketij objektivi, eshte punuar ne bashkepunim me GTZ per hartimin dhe miratimin e ligjit, i cili tashme eshte miratuar ne Qeveri dhe pritet te kaloje ne Parlament. Gjate vitit 2008, pas procesit te rishimkimit te lejeve, licencave, certifikatave dhe autorizimeve, Grupi i Licensimit dhe Task Force rekomanduan heqjen e 104 nga numri total prej 166 i tyre si te panevojshme dhe si barierra te pastra administrative.

❖ LIBERALIZIMI I TREGETISE

Dimensioni Rajonal

Eshte miratuar nga Kuvendi shqiptar projektvendimi per miratimin ne parim te marreveshjes ndermjet vendeve anetare te CEFTA-s dhe Mbreterise se Belgjikes, per vendqendrimin e Sekretariatit te CEFTA-s.

Ne takimin e Komitetit te Perbashket, tetor 2008, Kishinau, Moldavi vendi yne propozoi qe te behet harmonizimi dhe unifikimi i rregullave, i masave dhe standarteve ndermjet vendeve te CEFTA-s si dhe bashkepunimi per te eliminuar te gjitha barrierat e panevojshme qe demtojne tregtine ndermjet vendeve, e cila u mbeshtet edhe nga Sekretariati i CEFTA-s.

Ky takim ishte mjaft i rendesishem dhe vlen te theksohet se te gjitha propozimet qe Shqiperia kishte paraqitur jane miratuar nga vendet e CEFTA-s.

Marrëveshja e tregtisë se lire ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë hyri ne fuqi me **1 maj 2008** pas ratifikimit te saj edhe nga pala turke.

Me objektivin e zgjerimit dhe rritjes së volumit tregtar, nëpërmjet eliminimit të barrierave tregtare për produktet shqiptare, rritjen e volumit të eksporteve si dhe diversifikimin e produkteve për eksport nëpërmjet sigurimit të standardeve dhe cilësisë, si dhe duke besuar se kjo politikë liberalizuese do t'i shërbeje dhe do të forcojë procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, **Shqipëria i ka propozuar vendeve të EFTA-s iniciimin e negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me këto vende.** Ky objektiv është shtyre per vitin 2009, pasi vendet EFTA nuk ishin te gatshme per te vazhduar negociatat gjate vitit 2008, ashtu sic kishin vendosur ne takimin e pare negociator ne dhjetor 2007.

Dimensioni Global

Si vend anetar i OBT-se, Shqiperia duhet te monitoroje permbushjen e angazhimeve qe rrjedhin nga ky anetaresim si dhe zbatimin e legjislacionit te brendshem ne perputhje me Marreveshjet e OBT-se. Procesi i notifikimit te kuadrit ligjor, prane Organizates Boterore te Tregtise, eshte nje proces i vazhdueshem per dergimin e kuadrit ligjor per notifikim ne OBT, ne bashkepunim me ministrite e linjes. Materialet e ardhura nga institucionet pergjegjese jane notifikuar prane OBT-se.

Pjesemarrja ne raundin e negociatave te Dohes.

Vitit 2008 duhet konsideruar si nje vit shume i rendesishem per thellimin e liberalizimit global te ekonomise boterore, nepermjet negociatave qe po zhvillohen ne Gjeneve, ne kuader te Agjendes se Dohes per Zhvillim.

Ne kuader te shqetesimeve ne raportet vjetore të Bashkimit Evropian per ngritjen e kapaciteteve administrative të nëpunësve civilë, sidomos në kuadrin e veprimeve të përbashkëta dhe të harmonizuara të hartimit të politikave tregtare Drejtoria e Politikave Tregtare ka miratuar nje plan veprimi lidhur me **“Kapacitetet administrative per kordinimin dhe administrimin e politikës tregtare ne Shqiperi”**, pjese e te cilit eshte edhe pyetsori ne lidhje kapacitetet dhe aftesite qe institucionet shqiptare kane per politike berje. Gjate vitit 2008 ne përputhje me kete plan veprimi eshte arritur plotësimi i këtij pyetësori nga shumica e institucioneve te përfshira dhe po punohet per përmbledhjen e tij dhe paraqitjen e rezultateve.

Gjithashtu eshte miratuar nga parlamenti shqiptar, ndryshimet e Marreveshjes se TRIPS-it ne kuader te Axhendes se Dohas per Zhvillim.

IV. Heqja e Barrierave jo tarifore

Ne bashkepunim me Sekretariatit e OBT-se si dhe me ndihmen e misionit tone ne Gjeneve, u organizua konferenca per vleresimin e nevojave dhe prioriteteve ne fushen e lehtesimit te tregtise. Gjate nje jave te zhvillimit te Konferences Drejtoria e Politikave Tregtare OBT dhe SLT kane kontribuar ne organizimin e ketij evenimenti. Ajo ne bashkepunim me perfaqesues te ministrive te linjes, drejtorise se pergjithshem te doganave ka hartuar dhe pergatitur sipas prioriteteve tabelat perkatese duke marre ne konsiderate shqyrtimin e 49 masave te propozuara. Ky material i cili do te perkthehet ne gjuhen angleze do te paraqitet se shpejti ne OBT.

❖ MEKANIZMAT RREGULLUES DHE TE KONTROLLIT

Licensimi dhe Koncesionet

Ne fushen e licensimit, METE ka siguruar nje koordinim institucional te strukturave pergjegjese ne dobi te vendim-marrjes per dhenien e licencave minerare, dhe kete e ka siguruar me ngritjen e nje sistemi elektronik te dhenash, permes se cilit sigurohet kthimi i pergjigjes vetem ne disa dite per subjektet e interesuara. Pikerisht ne saj te funksionimit te ketij sistemi elektronik, eshte bere e mundur procedimi brenda afatit te lejuar administrativ i nje numri teper te madh kerkesash per t'u pajisur me leje minerare. Gjate vitit 2008, METE ka proceduar me 950 kerkesa per licenca minerare, afro 80 kerkesa/muaj.

Lehtesimi i procedurave ne dhenien e licencave dhe promovimi i burimeve natyrore te vendit, ofroi investitore potenciale si Antea Cement, Cementos Aguila etj. te cilet kane hyre ne marredhenie kontraktuale me METE (kontrata keto te miratuara ne Parlament) per shfrytezimin e disa vendburimeve per 99 vjet, duke siguruar jo vetem shfrytezimin e mineraleve te dobishem, por edhe perpunimin teknologjik te tyre ne Shqiperi, ne perputhje me praktikat me te mira te industries dhe standartet nderkombetare per mbrojtjen e mjedisit. Investimet e parashikuara ane keto kontrata vleresohen ne afro 1,5 miliard Euro.

Te tjera kompani serioze minerare jane ofruar ne: (i) *zbulimin e mineraleve metalore si baker, krom, nikel*; psh investitore kanadeze Tirex, Balkan Resources, austriake DecoMetal (DCM); (ii) *ne shfrytezimin e mineraleve gelqerore*; si psh. kompania italiane Fassa qe operon ne shfrytezimin dhe perpunimin e mineraleve gelqerore dhe numeron 11 fabrika perpunimi ne Itali dhe jashte saj; Colacem, qe numeron 10 impiante perpunimi ne Itali dhe tre terminale portuale, ndersa ka shtrire aktivitetin e saj minerar ne Tunizi, Kanada, Republiken Domenikane, Spanje e Montenegro; Seasif Grup mjaft i suksesshem ne disa sektore te ekonomise, midis te cileve edhe atij te ndertimit dhe perpunimit te mineraleve jometalore.

Aktualisht, ne kete sektor operojne 39 kompani te huaja (kanadaze, italiane, greke, australiane, zviceriane, austriake, ruse etj.) qe operojne ne 81 objekte minerare; 511 kompani vendase ne ne 607 Objekte Minerare.

Numri i licencave minerare ka ardhur ne rritje:

Viti 2005	87 Licenca Minerare
Viti 2006	59 Licenca Minerare

Viti 2007	140 Licenca Minerare
Viti 2008	176 licenca (90 leje shfrytezimi; 60 zbulimi dhe 21 kerkim-zbulimi)

Numri i madh i lejeve te shfrytezimit gjate vitit 2008, pervec sa me sipër edhe si rezultat i rritjes se cmimit te metaleve ne tregun botëror, rritje kjo qe u shoqerua me nje rritje te prodhimit dhe eksportit te metaleve, kryesisht krom dhe baker.

Rritja e ketij sektori eshte shoqeruar pa dyshim me nje rritje te investimeve ne kete sektor nga 11.49 milion USD per vitin 2005, ne 24.15 milion USD ne vitin 2006; 32,6 mln USD per vitin 2007 dhe 54.2 mln per vitin 2008.

Po keshtu, numri i punonjesve te punesuar ne kete sektor ka arritur nga 1800 vete ne vitin 2005, ne mbi 7000 vete ne vitin 2008.

Zhvillimi i sektorit minerar, rritja e numrit te subjekteve te licensuar dhe hapja e fronteve te reja te punes eshte shoqeruar me nje monitorim te kujdesshem te aktivitetit minerar.

Ne vazhdimesi, DLMK ka ndjekur kete proces dhe ka inicijuar disa akte nenligjore, si me poshte renditur, zbatimi i te cilave ka beret e mundur monitorimin e sektorit dhe shmangien e rreziqeve minerare:

- Urdheri i Ministrit Nr. 223 dt. 31.03.2008 ne “Mbikqyrjen e aktivitetit minerar ne zonen qendrore e jugore...ndikimin e aktivitetit minerar privat, brenda dhe rrotull saj dhe percaktimin e masave te nevojeshme per shmangjen e rrezikut nga shembjet”;
- Urdheri i Ministrit Nr. 488 dt.30.06.2008 “Mbi percaktimin me koordinata te zonave te rrezikshmedhe rreziqet e futjes se ujrave te sip. ne punimet e minieres veriore Bulqize”;
- Ne funksion te mbrojtjes se ambientit, Urdheri i Ministrit Nr. 434 dt. 19.06.2007 “ Ndalimin e dhenies se Lejeve te Reja Minerare per Gurin gelqeror ne zonen Fush kruje-Kruje”;
- Ne funksion te zgjidhjes se problemit te turbullimit te ujit te pijshem qe furnizon qytetin e Beratit e zonen perreth, si edhe per te rritur cilesine e furnizimit me uje per te ardhmen, brenda zones ujembledhese te burimeve, per gjashte subjekte u ndalua ushtrimi i aktivitetit minerar per nxjerrjen e pllakave dhe gurit gelqeror duke percaktuar ne terren nje kontur (dhene me koordinata) i cili ndan qarte, zonen e lejuar kundrejt zones se ndaluar per shfrytezim;
- Ne funksion te mbrojtjes se jetes se njerezve, u shkaterrua Guri Masiv qe rrinte varur prej kohesh mbi banesat e lagjes Mangalem, Berat duke kercenuar seriozisht jeten e banoreve te kesaj lagje;
- Me Program te Vecante te miratuar nga Ministri, me struktura te vecanta u mbylleen punimet e vjetra ne ish Minierat e ish Nd/jeve Minerare ne gjithë territorin e vendit. (Galeri, Traverbangje, Puse, mbushje te gropave ne sip. si rezultat I influences se shfrytezimit nentoksor);

- Ne funksion te mbrojtjes se Monumenteve te Natyres, Monumenteve Arkeologjike, Gjeomonumenteve jane identifikuar dhe marre masat per mos demtimin e tyre nga shfrytezimi me Lende eksplozive prane “Shpelles se Ujkut” ne Bilisht (Devoll). Ne mbrojtjen e murit te “Kalase se Dorezit” prane fshatit Peze, Tirane. Ne mbrojtjen e rruges Nacionale per ne Sarande, si rezultat i shfrytezimit nentoksor te ish Minieres se kripes Dhrovjan;
- Ne funksion te ruajtjes te zonave Turistike (Limjon, Sarande) eshte pezulluar aktiviteti minerar i subjekteve te licencuar me pare;
- Ne funksion te shmangjes se rreziqeve per popullsine perreth Objekteve Ushtarake si ne Tunelet e Mirakes, Librazhd (Depo armatimi,) eshte ndaluar veprimtaria minerare e subjekteve te licencuar me pare, prane ketyre objekteve.

Ne zbatim te kuadrit te ri ligjor “per koncesionet”, jane proçeduar dhe identifikuar 120 propozime te pakerkuara, jane hapur gara, vleresuar dhe negociuar 50 kontrata koncesionare te firmosura, me nje investim total prej mbi 200 milion Euro, me nje fuqi te instaluar prej 216 MW dhe nje energji prej 700 Gwh/vit. Permendim ketu, kontraten koncesionare te lidhur midis METE dhe Kompanise Austriake Verbund, leader ne prodhimin e energjise hidro ne Europe, me 107 hidrocentrale, 9 termocentrale dhe 50 nenstacione elektrike, e cila do te ndertoje ne Ashte 2 stacione energjie me nje kapacitet total deri ne 48MW.

Eshte miratuar nga Keshilli i Ministrave dhe ne proces te ratifikimit ne Parlament, kontrata koncesionare, midis METE dhe Bashkimit te shoqerive EVN dhe Stakraft, te cilat se bashku ne menyre solidare marrin pergjegjesine e realizimit te kaskades se Devollit me nje investim prej rreth 1 miliard Euro dhe kapacitet 319MW. Kompania Austriake EVN zoteron kapacitete gjeneruese te energjise elektrike ne afro 2 mije MW dhe ofron sherbime per mbi 2,5 milion kliente dhe Kompania Norvegjeze Statkraft numeron te pakten 70 hidrocentrale ne Norvegji, Suedi dhe Finlande dhe eshte prodhuesi kryesor i energjise elektrike ne vendin e tij.

Nderkohe, vazhdojne procedurat e vleresimit dhe negocijimit te projekteve koncesionare. Komisioni i Vleresimit te Ofertave “per ndertimin me koncesion te hidrocentraleve” po shqyrton propozimet e ardhura ne 23 gara; fuqia totale e parashikuar per keto 23 vepra hidroenergjetike eshte 970 MW. Ketu perfshihet edhe gara e hapur nga METE per ndertimin e hidrocentralit te Skavices, mbi lumin Drini i Zi, me nje kapacitet nga 220 MW-350MW. Kjo veper me rendesi te madhe hidroenergjetike ne vend, ka terhequr vemendjen investitoreve strategjike te tille si RWE, Kelag, Kepco, Statkraft, Verbund, TGK-Skavica.

Ne faqen e internetit te METE, publikohen rregullisht te gjitha njoftimet per pjesemarrje ne garat e shpallura per ndertimin e hidrocentraleve ne akse te ndryshme te vendit.

Aktualisht jane 19 gara te shpallura, dhe rreth 30 propozime te ardhura rishtazi, te cilat jane ne fazen paraprake te vleresimit nga Oponenca Teknike Shteterore dhe Grupi i Vleresimit te Projektpropozimeve ne METE.

Mbikqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatoreve

Përafrimi i legjislacionit teknik me “Acquis Communautaire”

Ne drejtim te transpozimit te plote te direktivave te “Përafrimit te Ri” ne legjislacionin shqiptar, ne zbatim te Ligjit nr. 9779, dt. 16.07.07 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit te produkteve jo ushqimore”, si dhe ne përputhje me Planin Kombëtar Zbatimit te MSA, janë hartuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave 6 VKM dhe jane dërguar per miratim, ne Këshillin e Ministrave, gjate muajit janar, 1 projekt ligj *Për treguesit e konsumimit te energjisë nga pajisjet për përdorim shtëpiak nëpërmjet etiketimit dhe informacionit standard te produkteve*” si dhe 3 projekt vendime

Jane ne process hartimi 1 projekt ligj “Per detergjentet” dhe 2 VKM per ngritjen e strukturave pergjegjese per mbikqyrjen e tregut dhe vleresimin e konformitetit.

Mbrojtja e konsumatorëve

Ne muajin prill u miratua nga Kuvendi, Ligji i ri nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e konsumatorëve”, i cili shenon nje hap te rendesishem si ne perafimin e legjislacionit te konsumatorit me ate europian.

Pas miratimit te ketij ligji eshte punuar ne drejtim te hartimit te akteve nënligjore, qe do te sigurojnë funksionimin e strukturave institucionale për mbrojtjen e interesave te konsumatorëve - Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatorëve dhe Këshilli Bashkërendues për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe transpozimin e plote te direktivave evropiane:

Hartimi dhe miratimi ne Këshill te Ministrave, i paketës me tre projektvendime, ne zbatim te ligjit te mbrojtjes se konsumatorëve, qe transpozojne plotësisht direktivat evropiane përkatëse te fushës se mbrojtjes se konsumatorëve, parashikuar edhe ne Planin Kombëtar te Zbatimit te MSA: Mbi kontratat jashtë qendrave te tregtimit; Mbi kontratat e paketave te udhëtimit; Mbi kontratat ne distance.

Fusha antidumping

Iniciativat ligjore

Ne zbatim te kuadrit te ri ligjor te fushës antidumping, janë hartuar dhe miratuar ne vitin 2008, këto VKM nr. 429 date 08.04.2008 “Për emërimin e anëtarëve te Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet” dhe VKM Nr. 1616, dt. 10.12.2008 “Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit te Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet”,

Regjistri i kolateralit

Regjistri i Kolateralit ka realizuar ne vijimësi objektivat e parashikuara për vitin 2008:

- Lehtësimi dhe inkurajimi i financimit te siguruar mbi pasuritë e luajtshme
- Sigurimi i zbatuesmerise se ligjit mbi pretendimet pasurore mbi pasuritë e luajtshme.

duke krijuar efektivitet dhe cilësi ne shërbimet qe ai ofron ndaj Bankave dhe institucioneve financiare.

Zbatimi i parimeve baze te ndihmes shtetërore

Plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, udhëzime, rekomandime

Në vijim të plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e ndihmës shtetërore Komisioni i Ndihmën Shtetërore ka nxjerrë dy udhëzime të reja: “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, dhe “Për metodologjinë e analizës të kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit

Zbatimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore

Në kuadër të vlerësimit ekonomik dhe legjislativ të skemave të ndihmave shtetërore në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për ndihmën shtetërore” dhe rregulloret përkatëse, janë shqyrtuar 2 plane të reja për dhënie ndihme në formën e skemave të ndihmës shtetërore, për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje etj dhe për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW

Sigurimi i transparencës. Raporti vjetor i ndihmave shtetërore.

Eshte pergatitur dhe miratuar “Raporti vjetor për ndihmat shtetërore”. Duke qenë raporti i parë që përgatitet në kuadër të transparencës në marrëdhëniet ndërkombëtare të tregtisë, për sa i përket ndihmave shtetërore dhe subvencioneve, ai ka dhënë një përshkrim të objektivave kryesore në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumenteve të përdorura për gjithë periudhën 2005-2007.

ADMINISTRIMI I PRONES PUBLIKE

- Per vitin 2007 eshte miratuar 2,084,734,688 leke dividend, nga i cili aktualisht eshte arketuar 1,920,157,166 leke. Ne dividendin e ketij viti ka ndikuar dividenti i derdhur nga sh.a ARMO dhe AMC sh.a.
- Eshte kërkuar shpallja ne falimentim e shoqërive, Frigoriferi Durres, Industrial Impex, Art Import-Eksport Tirane, Gatic sh.p.k Gjirokaster dhe Rekor Albania Gjirokaster ne likuidim; Jane shpallur ne likuidim Sh.a”Nimex”, Durres, Tregetimi i Librit Artistik dhe Shkencor, Tirane, Shtepia Botuese “Naim Frasheri”, Tirane, Qendra e Llotarive Sportive, Tirane, dhe ka perfunduar procesi i likuidimit per sh.a”Hotel Arbana”Tirane.
- Është bere listimi i objekteve te mundeshme per tu dhene me qira ose enfiteoze.
- Eshte realizuar perpunimi i 9 kerkesave nga qiramarresit per privatizim te objekteve, ne rastet kur investimet kalojne vleren e 150% te vleres se truallit, prej te cilave per 5 kontrata qiraje dokumentacioni eshte percjelle per privatizimin te objekteve ne favor te investitorëve.
- Jane përpunuar materialet dhe jane kryer procedurat e konkurrimit per dhenien me qira te 17 objekte prone shteterore, ndersa ne 12 raste, dosjet jane kthyer perseri ne njesine administrative, per plotesim dokumentacioni.
- Jane lidhur 14 kontrata te reja qiraje per objekte prone shteterore, prej te cilave 9 raste per zhvillim te aktivitetit ne fushen e aktiviteteve prodhuese dhe 5 raste per zhvillimin e aktiviteteve ne fushen e programeve televizive. Ne kontratat e lidhura te reja ne 3 raste shoqërite Qiramarrese jane shoqeri te huaja ose ne ortakëri me shtetas te huaj.
- Jane realizuar per vitin 2008 te ardhurat nga dhenia me qira ose enfiteoze e pasurive shteterore ne masen 99%, duke sjell nje impakt ne buxhetin e shtetit rreth 1,5 milion euro.
- Nga dhenia e objekteve me qira eshte realizuar prej Qiramarresve ne keto objekte sigurimi i rreth 4700 vende pune, per te cilat jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe te sigurimeve shoqerore.

❖ PROBLEMATIKA BUXHETORE

I. Realizimi i treguesve buxhetor per sistemin e METE per vitin 2008 paraqitet:

-Shpenzimet per paga jane realizuar ne masen 93%. Te krahasuara me realizimin faktik te vitit 2007 jane ne te njejtin nivel. Theksojme se mos realizimin me te ndieshem e ka QKR dhe ATRAKO.

-Shpenzimet operative jane realizuar rreth 94% nga 89 % te realizuara ne vitin 2007, kjo tregon per menaxhim me te mire te ketyre shpenzimeve.

Ketu duam te theksojme se gjate ketij viti jane shlyer nje pjese e mire e detyrimeve per vendimet gjyqesore te mbartura ne vite, ne shumen 17 mln leke. Me mosrealizim per keto shpenzime paraqitet IQT, ATRAKO dhe ALBINVEST.

-Investimet kapitale ne total jane realizuar ne masen 88% **nga te cilat investimet e patrupezuara ku** perfshihen temat studimore per SH.GHJ.SH. dhe AKBN jane realizuar ne masen **100%** dhe **investimet e trupezuara 81 %**. Me mos realizim paraqitet programi “Mbeshtetje per zhvillim ekonomik” me 65 % ku permendim projektin “Studim i fizibilitetit ekon.financiar dhe teknik e mjedisor per parkun Elbasan” per mos arritje te afateve te tenderimit per arsye te ndryshimit te procedurave dhe kalimit te tyre On Line si dhe Fondi i Konkureshmerise per arsye te mos plotesimit te dokumentacionit perkates per perfitimin e ketij fond dhe procedurave kohore te zgjatura. Nderkohe theksojme se disa nga insitucionet ne varesi panvaresisht nga kerkesat e vazhdueshme per transferimet fondesh nuk arrihen ti realizonin ato brenda afateve te caktuara ku mund te permendim IQT dhe AKBN.

-Investimeve Kapitale me financim te huaj, jane realizuar ne masen 44% te planit te rishikuar per efekt te mosrealizimit te Projektit “Mbeshtetje per SME” e perfshire ne programin “Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik “ si pasoje e fillimit me vonese te implementiit te projektit, ne Maj te vit 2008 si dhe te moszbatimit te projektit BERIS sipas planit te prokurimit.

Ketu duam te theksojme se si rrjedhoje e ndjekjes dhe monitorimit te treguesve buxhetore per vitin 2008 jane propozuar **disa ndryshime ne planin fillestar te financimeve buxhetore duke i kaluar fondet ne ato projekte te cilat kishin prioritet ose mundesi me te madhe realizimi.**

II. Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesem 2009-2011

Sic dihet ky proces kalon ne dy faza .

Ne pergatitjen e buxhetit 2009-11 jane mbajtur parasysh kerkesat e strategjive sektoriale dhe ndersektoriale per hartimin e te cilave METE eshte drejtperdrejt pergjegjese (Strategjia e Biznesit dhe Investimeve, Strategjia e Energjise, Strategjia Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal si dhe Strategjia e Mbrojtjes se Konsumatorit dhe Mbikqyrjes se Tregut).

Se pari nje arritje eshte harmonizimi me i mire dhe me i sakte i politikave dhe strategjive sektoriale me financimet buxhetore duke u mbeshtetur ne Programin e Qeverise, MSA si dhe ne perputhje me Sistemin e Planifikimit te Integruar.

Procesi i PBA eshte i shoqeruar edhe Monitorimin dhe Vleresimin e tij.

Nje arritje per vitin 2008 eshte pergatitja e Raportit te Monitorim Vleresimit te PBA per vitin 2007 dhe cdo 3-mujor te vitit 2008 ne perputhje me formatet e derguara nga MF. Ky raport pasqyron performancen e punes se METE e shprehur ne produkte konkrete per cdo program buxhetor si dhe kostot perkatese per cdo produkt. Kjo eshte nje praktike qe ka filluar per here te pare ne vitin 2007 ne mbeshtetje Udhezimit “Per pergatitjen e Buxhetit” dhe deri ne fund te vitit 2008 eshte perballuar totalisht nga sektori i buxhetit. Kete vit edhe monitorimi dhe vleresimi I PBA do te filloje te behet nepermjet programit Orakull.

Veme ne dukje se nga ana e institucioneve te varesise nuk ka patur nje pergjegjshmerin e duhur ne percaktimin e produkteve per cdo institucion dhe program. Mos percaktimi i sakte i produkteve te cdo institucioni ka sjelle si pasoje mos percaktimin e kostove te produkteve per cdo program gje qe shoqerohet me kerkesa te vazhdueshme per ndryshim te fondeve nga nje projekt ne tjetrin.

Treguesit Statistikor

U hartua dhe u publikua ne website e ministrise, Buletini Vjetor Statistikor i METE per vitin 2007, ne forme tabelore dhe grafike sipas nomenklatures se aktiviteteve qe kryen METE.

❖ **PERFORMANCA FINANCIARE DHE E BURIMEVE NJEREZORE**

Shpenzimet per periudhen 01 janar -31 dhjetor 2008 jane realizuar ne total, ne masen 97% ose nga 360958 mije leke te programuara jane realizuar 349512 mije leke, me nje mosrealizim 11446 mije leke.

Ne baze te struktures se METE-s miratuar me urdherin e Kryeministrit nr. 28, date 7.03.2008, rezulton:

	<u>Plan</u>	<u>Fakti</u>
• Nr. punonjesve ne METE Gjithsej:	174	167
• Nr. punonjesve te DSHP Gjithsej	28	27
• Nr. Punonjesve me kontrate te miratuar nga MF	18	16
TOTALI	220	210

Ne liste pritje 2 punonjes (perfunduar ne tetor 2008)

Nr. i punonjesve per vitin 2008, ne institucionet e varesise sipas struktures se miratuar si dhe miratimit me kontrate nga MF sipas udhezimit nr.2 paraqitet si vijon:

	<u>nr. Punonj ne Strukture</u>		<u>Mirat. me kontrate nga MF</u>	
	<u>Plan</u>	<u>Fakt</u>	<u>Plan</u>	<u>Fakt</u>
Gjithsej	306	303	15	15

Nga numri i punonjesve te METE-s, me emerime te perkohshem deri ne perfundimin e procedurave te konkurimit qe rezultojne ne fund te vitit 2008 gjithsej: **6 punonjes.**

-Ne fillim te vitit 2008 kane rezultuar 27 vende vakant (te perfshire ne vendet vakant edhe ato ne te cilen jane pozicionuar punonjes me emerim te perkohshem

-Kerkuar DAP-it per t'u shpallur dhe rishpallur per konkurs per vitin 2008 Gjithsej: 16 pozicione

-Jane realizuar per vitin 2008 gjithsej: 21 konkurse

-Punonjes te konfirmuar nepunes civil pas perfundimit te periudhes se proves per v.2008 gjithsej:25

-Me dt. 31 Dhjetor 2008 kane rezultuar 8 vende vakant.

-Trajnime dhe seminare te kryera nga punonjesit gjithsej pjesemarres :63 punonjes

-Punonjes te METE-s qe perfitojne shperblim per tituj/grada, miratuar nga DAP gjithsej: 23 punonjes

-Punonjes te instituc. te varesise mirat. nga DAP, per te perfituar shperblimin per tituj/grada gjithsej **7 punonjes**

Jane hedhur te dhenat e punonjesve (perfshire dhe punonjesit e rinj dhe te institucioneve te varesise) sipas rubrikave te rregjistrit qendror

-.Trajnime dhe seminare te kryera nga punonjesit gjithsej pjesemarres : 63 punonjes.

nga keto:

a. Pjesemarres ne trajnime jasht vendit **24 punonjes**

b. Pjesemarres ne trajnime brenda vendit nga te cilet: **39 punonjes**

- Kane kryer trajnim 2 javor nga ITAP punonjes ne periudhe prove per v. 2008 **21 punonjes**

Tematikat: Trajnime per nepunes ne periudhe prove & sipas specifikave dhe temave te percaktuara nga drejtorite.

-. Jane hedhur te dhenat e punonjesve (perfshire dhe punonjesit e rinj dhe te institucioneve te varesise) sipas rubrikave te rregjistrit qendror

❖ KONTROLI I BRENDSTEM

Fushat kryesore te veprimtarise se auditimit te brendstem kane qene : *kontrollat e brendstem, financiare dhe te drejtimit.*

Sipas Planit Vjetor te Auditimit **jane parashikuar te kryhen per vitin 2008, gjithsej 50 auditime dhe jane realizuar gjithsej 55 auditime .**

Vlera e pergjithshme e zbulimeve nga auditimet per kete periudhe rezulton ne shumen 338.659 mije leke, te ndara sipas rubrikave, paraqiten :

- Nga struktura e auditit prane Ministrise ne shumen 86.611 mije leke.

- Nga struktura e auditit ne subjektet e varesise ne shumen 252.048 mije leke.

A. Evazion fiskal , ne shumen 17.839 mije leke, 99.5 % e te cilit eshte zbulim i bere vetem nga struktura e auditimit prane METE.

B. Mungesa e demtime, ne shumen 44.399 mije leke, kerkuar dhe ngarkuar e gjitha per zhdemtim.

C. Shkelje te disiplines financiare me dem ekonomik, ne shumen 276.421 mije leke, kerkuar dhe ngarkuar e gjitha per zhdemtim.

D. Shkelje te disiplines financiare pa dem ekonomik :

- Te disiplines financiare, ne 276 raste ne vleren 32.965 mije leke.

- Te procedurave ligjore, ne 1047 raste, ne vleren 147.550 mije leke.

Nga struktura e auditimit prane METE jane dhene : gjithsej 375 rekomandime dhe propozime

Krahas zbulimeve dhe masave te rekomanduara , rendesi e vecante i eshte kushtuar ndjekjes dhe zbatimit te masave te rekomanduara.

Vlen te permendim se ne cdo praktike te **auditimit** eshte bere **identifikimi dhe vleresimi i rrishtit** i cili ka ndikuar ne arrijten e objektivave te entitetit.

Fusha me risk me te larte eshte ajo ne arketimin e te ardhurave nga qeradhenia e objekteve prone publike dhe **zbulimet ne kete fushe zene gati 42 % ndaj vleres totale zbulimit..**

❖ **PROJEKTAKTET LIGJORE DHE NENLIGJORE, CESHTJET GJYQESORE**

Kane qene parashikuar per tu iniciuar nga METE, 64 akte ligjore, nga te cilat **jane realizuar 37 akte ligjore** Aktet e tjera, 27 prej tyre, nuk kane ardhur ne METE pasi jane ne proces nga entet e varesise, si RISHMI, AKBN, Drejtoria e Standardizimit etj.

Gjithashtu gjate vitit 2008, **jane realizuar edhe 52 akte te tjera ligjore** qe nuk ishin te parashikuara, nga te cilat 43 projektvendime, 8 projektligje dhe 1 projekturder i Kryeministrit.

Gjate vitit 2008 **ky sektor ka perfaqesuar 144 ceshtje gjyqesore**, nga keto 62 ceshtje jane te fituara, 74 ceshtje jane ne proces dhe 8 ceshtje gjyqesore jane te humbura.

Nder aktet ligjore me te rendesishme mund te permendet:

-Ligji i ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” eshte miratuar nga Parlamenti me ligj Nr.9901, datë 14.4.2008.

-Ndryshimi i ligjit “Per ndermarrjet e vogla e te mesme”, Nr.8957, date 17.10.2002, me **ligjin Nr.10042, date 22.12.2008**. Ndryshimi konsiston ne perafrimin pothuaj te plote te rekomandimit 2003/361/EC, kryesisht ne perkufizimin e SME-ve dhe ne menyren e lidhjes se ndermarrjeve me njera tjeter.

❖ **-Ligji per firmen elektronike** Eshte miratuar nga Parlamenti **ligji Nr.9880, datë 25.2.2008** “Për nënshkrimin elektronik”

. INFRASTRUKTURA E CILESISE

Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 272 datë 5.03.2008 si pjesë e Strategjisë sektoriale “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri” ishte progresi tjetër i rradhës në fushën e miratimit të legjislacionit. Për herë të parë objektivat dhe planet e zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri janë të koordinuara dhe të bashkërenditura.

Metrologjia

Përmirësimi i paketës ligjore

Ne zbatim te ligjit “Per metrologjinë”, miratuar me daten 14.02.2008, i cili rregullon nder te tjera, aktivitetin ne fushen e mbajtjes se etaloneve dhe te kalibrimeve, duke i dhene mundesi subjekteve te tjera pjesmarrjen ne keto aktivitete mbi bazen e konkurrences dhe te kompetences teknike, u vijua puna per hartimin e paketes me aktet nenligjore, te cilat rregullojnë organizmin edhe funksionimin e DPM-se si dhe adoptojnë Direktiva të Perafrimit të Vjetër dhe Perafrimit të Ri. Janë miratuar 6 vendime të Keshillit të Ministrave, si me poshte:

Implementimi i strategjise se zhvillimit kombetar të metrologjise.

DPM po punon intensivisht per implementimin e saj, ku nje nder objektivat paresore te strategjise eshte sigurimi dhe ndertimi i infrastrukturës se nevojshme laboratorike, ngritja e Qendres

Kombetare të Metrologjisë. Ndertimi i Qendres Kombetare të Metrologjisë është planifikuar të realizohet me mbështetjen e projektit BERIS të Bankes Botërore, komponenti për Infrastrukturen e Cilesisë. Aktualisht është siguruar trualli për ndertimin e qendres së re të metrologjisë me VKM nr. 312 datë 12.03.2008. Është në proces përfundimtar prokurimi për firmën fituese për projektimin dhe supervizionin e Qendres Kombetare të Metrologjisë.

Gjatë kësaj periudhe **kontrolli në treg** është përqendruar në *Fushën e produkteve të parapaketuara*, ndaj *Subjekteve të tregtimit të karburanteve* si dhe *Aktivitetet inspektuese* ndaj prodhuesve dhe tregtuesve të bukes, ndaj subjekteve tregtuese të gazit të lenget në bombola, ndaj subjekteve tregtuese të karburanteve, ndaj subjekteve paketuese për vajin ushqimor, ndaj subjekteve paketuese në përgjithësi, etj.

Gjithashtu gjatë periudhës Janar – Dhjetor të vitit 2008 është rritur numri i kalibrimeve të mjeteve matëse në masën 5% dhe e numrit të inspektimeve për zbatimin e ligjshmerisë në fushën e peshmatjes në masën 6%, krahasuar me 2007.

Akreditimi

Gjatë vitit 2008 janë akredituar 5 organizma të vlerësimit të konformitetit nga të cilat: 1 Laborator testues, 3 Organizma inspektues dhe 1 Organizëm çertifikues produktësh.

Janë kryer 5 vizita mbikqyrëse, 3 riakreditime dhe 5 vizita paravlerësuese. Janë katër *laboratorë të rinj në fazë aplikimi në fushat e ndërtimit, lekurëve, ujrave dhe ambjentit*.

Në aspektin ndërkombëtar, institucioni përgjegjës për akreditimin u pranua anëtare si organizëm akreditues në IAF (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit), u firmos Marrëveshja e Mirëkuptimit me IAF (IAF MoU), u dorëzua i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me EA (Organizmin Europian të Akreditimit). Janë nënshkruar tre marrëveshje bashkëpunimi me organizmat akreditues të vendeve të rajonit

Adoptimi i Standardeve Europiane.

Në zbatim të PKZMSA, deri në fund të vitit 2008 DPS kishte planifikuar të adoptojë si standarde shqiptare 80% të totalit të standardeve EN të të dy rrganizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC, ndërkohë që janë adoptuar 88.8% të tyre

Gjatë vitit 2008 janë ratifikuar gjithsej 4066 standarde dhe dokumente standartizimi, nga të cilat 2765 janë standarde evropiane.

Gjatë këtij viti janë shitur gjithsej **1404** standarde ose e shprehur në përqindje 24% më shumë se sa viti 2007, nga të cilat për këtë vit **1145** standarde janë standarde Europiane dhe ndërkombëtare (S SH EN dhe S SH ISO/IEC), dhe vetëm standarde Europiane (S SH EN) janë **1043** përkundrejt **789** standardeve S SH EN që janë shitur gjatë 2007. Gjatë vitit 2008 janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Agjensinë Rajonale të Zhvillimit në Tiranë, me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë. Këto marrëveshje janë të rëndësishme për DPS sepse tentojnë përfshirjen e biznesit në procesin e standardizimit, rritje të promovimit dhe rëndësisë që ka përdorimi i standardeve Europiane e ndërkombëtare, rritje të përdorimit të këtyre standardeve nga biznesi vendas dhe për rrjedhojë edhe rritje të të ardhurave të DPS nga shitja e standardeve.

Pronesia industriale

Iniciativat ligjore.

Është aprovuar ligji “Për Pronësinë Industriale” si dhe aprovimi i ndryshimeve në Ligjin Nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara.

Anetaresimi ne organizma nderkombetare

Në kuadër të anëtarësimit në Zyrën Evropiane të Patentave, në muajin Shkurt 2008, u paraqit kërkesa zyrtare për anëtarësimin në Zyrën Evropiane të Patentave. Kjo kërkesë u paraqit pasi u krye një vlerësim nga EPO rreth kapaciteteve aktuale të Zyrës Shqiptare të Patentave dhe Markave si dhe pasi u vlerësua impakti i këtij anëtarësimi referuar eksperiencës së Zyrës Sllovene.

Në 19 Qershor 2008 Këshilli Administrativ i EPO-s aprovoi kërkesën për anëtarësimin e Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave me anë të vendimit CA/D10/08. Mbas këtij momenti mbetet të ratifikohet EPC-2000 dhe të depozitohen instrumentat përkatës në EPO.

në vitin 2008 numri i aplikimeve në total ka qenë 377 aplikime per patente nga të cilat: 363 nga EPO, 7 aplikime kombëtare dhe 7 aplikime PCT. Po gjatë këtij viti janë regjistruar 541 Patenta dhe 846 Marka.

AGJENSIA SHQIPTARE E BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Nje nga synimet dhe objektivat kryesore te identifikuar ne strategjine e Albinvestit dhe mjaft te rendesishme per Sektorin e SME-ve eshte fokusimi ne permirsimin,forcimin kapaciteteve tyre per te dale ne eksport me produkte cilesore dhe konkruese si ne tregun rajonal edhe ate European.

Projekti “Elisa” Per mesimin nepermjet internetit” per SME-te

gjate vitit 2008 u zhvilluan dy seminare promovuese me perfaqesues te mbi 35 kompanive private ne lidhje me perdorimin dhe impaktin qe ka perdorimi i internetit ne aktivitetin dhe zhvillimin e tregetise elektronike.

Fondi i Konkurrueshmerise

Skema e Garantimit te Kredive per Eksport

AGJENSIA E TRAJTIMIT TE KONCESIONEVE

Gjate periudhes janar – dhjetor 2008 Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve ka asistuar autoritetet kontraktuese në nivel qendror dhe lokal në të gjitha fazat e një projekti konçesionar, propozim i kërkuar apo i pakërkuar, duke filluar me:

Në kuadër të asistencës ofruar pushtetit qendror, orientimi kryesor i Agjencisë ka qenë asistenca për projektet konçesionare në një fushë prioritare siç është prodhimi i energjisë elektrike përqendruar kryesisht në projektet konçesionare për HECET e vogla, TECET dhe hidrocentralet dhe në përqidje më të vogël për projekte të tjera konçesionare si Kripa Sha Vlore, UMB Durrës apo Kombinati Kimik në Fier, Parqet industriale në Koplik, Vlorë, Shkodër dhe Shëngjin.

ATRAKO është përfshirë duke ofruar asistencën e saj në projekte konçesionare të iniciuara nga: **Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**, Ministria e Brendshme e cila ne kuadrin e implementimit të kartave të reja elektronike të identitetit dhe pasaportave elektronike me të dhena biometrike me asistencën e ATRAKO-s finalizoi ne korrik te vitit 2008 me nenshkrimin e kontrates koncesionare projektin koncesionar per prodhimin dhe shpendarjen e kartave elektonike te identitetit dhe te pasaportave biometrike, **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit**me nje projekt koncesionar i pari per nga natyra e tij ne Shqiperi, për dhënie me konçesion të sipërfaqes së tokës (toka të refuzuara dhe toka joproductive) deri në 1000 ha (jo më pak se 700 ha) për kultivimin e ullirit. Ky projekt eshte finalizuar ne dhjetor te 2008 me nenshkrimin e kontrates perkatese koncesionare dhe tashme ka filluar implementimi i tij nga koncesionari, **Ministria e Kulturës, Turizmit Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Finacave** për ndërtimin dhe operimin e terminalit doganor në Tiranë, ndërtimin e zyrave të administratës dhe mjediseve për magazine, pika shpërndarje, terminal magazinimi dhe përpunimi me kontenierë;

AGJENSIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE

Mbikqyrja e shfrytëzimit racional dhe efektiv të mineraleve

-Jane kontrolluar në vijimësi programet vjetore të zhvillimit, të paraqitur nga subjektet privatë, për rinovimin e lejeve minerare të shfrytëzimit për vitin 2008;

-Hartimi dhe perditesimi, në vazhdimësi, të hartave dixhitale të të gjithë rretheve, ku ka subjekte të licensuar. Gjatë këtij viti, është bërë verifikimi në vend i gjendjes teknike në mbi 556 objekte minerare. Materialet e grumbulluara dhe të përpunuara krijojnë mundësi për njohjen e gjendjes së tyre dhe problematikës që ata kanë.

-Hartimin e projektit dhe studimit për përcaktimin e zonave të rrezikshme në zonën Qendrore dhe Jugore të minierës së Bulqizës.

Projekti “Promovimi i burimeve të rinovueshëm dhe eficensës së energjisë”, financuar nga banka gjermane KfW.

Gjatë gjithë vitit 2008, AKBN në rolin e Agjensisë Ekzekutive të Projektit, në bashkëpunim edhe me METE-n, ka ecur përpara duke patur progres, lidhur me zbatimin e këtij projekti. Kështu nga AKBN janë kryer:

vlerësimi tekniko-ekonomik i projektit të qendrës së zhvillimit “Pëllumbat”, për të arritur në variantin optimal të tij;

analiza e studimit të fisibilitetit të ndërhyrjeve në objektin e qendrës së zhvillimit “Pëllumbat”;

analiza e dokumentave të tenderit dhe realizimi i procesit të prokurimit, për objektin e qendrës së zhvillimit “Pëllumbat”;

monitorimi i progresit të projektit dhe trajtimin e problemeve edhe për kopshtet e fëmijëve në Bashkitë e Kamzës dhe Kavajës.

Përgatitja e projektligjit të burimeve të rinovueshëm

Kjo detyrë është në fazën përfundimtare të saj, që është përfshirja, në tekstin e projektligjit, të mendimeve dhe vërejtjeve të institucioneve të tjerë, detyrë për të cilën është dashur të shqyrtohen aktet juridike (direktivat e Bashkimit Europian, kuadrin ligjor të vendeve të ndryshëm, që kanë të bëjnë me burimet e rinovueshëm), dhe t'i përshtasin në kushtet e vendit dhe me legjislacionin shqiptar etj..

Përgatitja e bilancit kombëtar të energjisë për vitin 2007

Bilanci kombëtar i Energjisë për vitin 2007 së bashku me relacionin përkatës përfundoi në muajin Shtator 2008.

INSPEKTORIATI QENDROR TEKNIK

Inpektimi në enët nën presion dhe kaldajat e avullit

Jane inspektuar gjithsej 460 Subjekte; Kaldaja avulli gjithsej 142; Pajisje Nen Presion gjithsej 1390.

Në krahasim me vitin 2007 ka rritje me 16 % të inspektimeve të kryera.

Gjatë vitit 2008 kanë ndodhur 11 raste avarie për arsye të mosrespektimit të rregullave të sigurisë.

Inspektimi i pajisjeve dhe instalimi i pajisjeve elektrike

Po të flasim me gjuhën e shifrave për të krahasuar treguesit e dy viteve të njëpasnjeshëm na rezulton se gjatë këtij viti janë realizuar **574 kontrole teknike** në krahasim me 387 kontrole të realizuara në vitin 2007, pra me shume 187 kontrole teknike.

Analiza e aksidenteve per vitin 2008

Gjate vitit 2008 kane ndodhur gjithesej 46 aksidente, nga keto 39 aksidente me vdekje dhe 7 aksidente me plagosje, djegeje apo demtime te tjera pa pasoja per jeten. Keto aksidente me pas jane klasifikuar sipas shkaqeve te ndodhjes se tyre me qellim te perqendrimit te punes parandaluese ne drejtimet e duhura.

Inspektimi i dhe kontrollit te naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre

Prej rreth 900 stacione karburanti qe ushtrojne aktivitet ne vendin tone, jo vetem ne kontrollet rutinë por edhe sondazhe janë kontrolluar 100 % e tyre, duke marrë 2 583 kampione benzinë e diezel gjithësej:

Prej rreth 70 shoqëri anonime të pajisura me leje tregtimi të llojit “A”, “B” dhe “C”, qe ushtrojne aktivitet ne vendin tone, janë kontrolluar 100 % e tyre, duke marrë 294 kampione gjithësej:

Kontrolle cilësore para zhdoganimit në të gjitha pikat doganore të vendit, detare e toksore, gjithësej 2 066 kampione.

Gjatë vitit 2008 janë realizuar 5031 analiza laboratorike për kampionet në tregun e brendshëm si edhe para zhdoganimit.

Cilësia e karburanteve e lëndëve djegëse: - në dogana 100 % brenda standardit, në sha 100 % brenda standardit, në shpk 97,5 % brenda standardit

Kontrolle ne drejtim te respektimit te normave e kushteve teknike në impiantet e depozitimit dhe të tregtimit të karburanteve e lëndëve djegëse. Kontrolle teknike janë realizuar 1677 aktkontrolle, 311 janë aktndalesa kryesisht në pikat e shitjes së gln-së.

Situata ne drejtim te respektimit të normave e kushteve teknike.

Me propozim të IQT për mos respektim të normave e kushteve teknike , nga METE janë hequr lejet e tregtimit shoqërive:

Për mos respektim të normave e kushteve teknike ne pikat e shitjes se bombolave me gln janë propozuar 14 sanksione me gjobë në masën 200 000 - 300 000 lekë, për 6 subjekte në Tiranë, 1 në Elbasan, 1 në Fier dhe 6 në Lushnje.

QENDRA KOMBETARE E RREGJISTRIMIT

Nje nga objektivat kryesore te QKR ishte ofrimi i sherbimit ne te gjithe vendin dhe me siguri mund te themi se kete objektivi e kemi arritur plotesisht jane hapur sportelet e QKR ne 29 (njetzet e nente) rrethe ne te gjithe vendin.

Ne pershtatje te fluksit te madh te aplikimeve u be e mundur shfrytezimi maksimal i hapësirës se sportelit qender nga 4 (kater) spotele ne 10 (dhjete). Gjithashtu kjo mase u shoqerua edhe me shtim te numrit te punonjesve (nga 4 ne 72 ne total).

Duhet te theksohet se rregjistri elektronik tregtar qe QKR trashegoi kishte mangesi te theksuara ne t e dhenat e subjekteve tregtare ,ne morem persiper te plotesojme te gjithe regjistrin tregtar.

Plotesimi i te dhenave te subjekteve ka ndikuar ndjeshem ne ndergjegjesimin e subjekteve sa qe tani jane vete subjektet qe kerkojne te plotesojne te dhenat e tyre.

Eshte arriur te behet aplikim i thjeshtuar (pa patur nevojën e miratimit nga sektori I regjistrimit) per disa procedura si p.sh. Depozitimi I bilancit, gjenerimi I ekstraktit te thjeshte dhe historic, printimi I certifikatave te regjistrimit, etj. Jane depozituar gjithsej 7920 bilance, koha mesatare e procesimit te nje aplikim 16 min qe shkon ne nje total prej 2112 oresh pse 264 dite pune.

Numri total i aplikimeve te shtyrtuara ne QKR per periudhen janar –dhjetor 2008 ka arritur shifren 94.762 aplikime.

Faktoret qe ndikuan ne procesimin e ceshtjeve Brenda afatit 24 ore:

Shtimi I stafit efektiv(per sektorin e regjistrimit)-me 8 punonjes maj 2008

Informatizimi I plote I te dhenave ekzistuese sipas dosjeve te arkivave te gjykatave

Pershtatja e detyrimeve ligjore ne sistemin elektronik ne perputhje me ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “ per tregtaret dhe shoqerite tregtare si dhe ligjeve te tjera te posacme .(Vazhdim)

Me dt 14.04 .2008 ,Hyri ne fuqi ligji nr 9901 “ Per Tregtare dhe ShoqeriteTregtare”

Per kete arsye ,QKR realizoi (i)format e reja te aplikimit dhe ekstraktet per te dhenat e regjistrimit ne perputhje me ligjin e ri te shoqerive tregtare; (ii) format e aplikimit per regjistrimin e subjekteve te cilat sipas ligjeve te posacme kane detyrimin te regjistrohen ne QKR, (iii)formularet qe do te mundesojne aplikimin per transformimin, bashkimin dhe ndarjen e shoqerive tregtare (per here te pare)

SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Sherbimi Gjeologjik Shqiptar gjate vitit 2008 ka kryer studime dhe sherbime te rendesishme te organizuar ne 6 fusha kryesore si me poshte:

I. Vleresimi, menazhimi dhe monitorimi i ujrave nentokesore ne basenet kryesore ujembajtes me perparesi zonat turistike dhe urbane, percaktimi i mundesive te reja per furnizimin me uje.

II. *Rivleresim i pasurive natyrore.* Ne kete kuader do te perpilohet harta e re e Mineraleve te Dobishme te Shqiperise ne Shkalle 1:200000, do te rivleresohen nga ana ekonomike dhe gjeologjike torfat, qymyret dhe ranoret bituminoze; do te kryhen punime studimore me karakter kerkim-vleresimi per baker te pasur (seria e Gjegjanit-Kukes).

III. Studime komplekse ne sherbim te mire-administrimit te territorit dhe burimeve natyrore (gjeologjia-territori-ambienti) ne shkalle vendi dhe lokale, perfshire komponentin e gjeologjise, tektonikes, lendeve te para, hidrogjeologjine, gjeologjine inxhinierike urbane, gjeomorfologjine, mjedisin, gjeomagnetizmin, identifikimin e potencialeve te reja natyrore etj., ne ndihme te zhvillimit te harmonizuar te zonave turistike, urbane e rurale.

IV. Studime komplekse ne fushen e gjeomjedisit dhe monitorimi i tij.

V. Rreziqet gjeologjike dhe infrastruktura publike.

VI. Gjeoinformacioni Ne vazhdim te punimeve te kryera me pare per pergatitjen e bazes dixhitale hartografike, per perpunimin e informacionit per gjeologjine, lendet e para, gjeologjine inxhinierike, hidrogjeologjine, mjedisin etj. synohet perpunimi i metejshem dhe informatizimi standart i te dhenave baze.